



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.03-241

12.07.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 54 paragrafi (5) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2553/1 datë 20.06.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02- 2749/4 datë 12.07.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 22- të mbajtur më 11.07.2023, miratoi si vijon:

#### **Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO METROPOLIS SHPK Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 54 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrë që në shërbimin programor në radio, transmetuar më 6.6.2023, ishin sponsoruar lajmet, përkatësisht edicionet informative të emisioneve të shkurtra ditore me titull: "Lajme në Radion Metropolis" dhe "Një minutë lajm pozitiv".

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2553/1 datë 20.06.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR RADIO METROPOLIS SHPK Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

#### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejeve, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur ka cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet tjera të Agjencisë.

Sipas nenit 54 paragrafi (5) nga LSHMAAV, nuk lejohet sponsorizimi i lajmeve, programeve aktuale-informative për ngjarjet aktuale dhe programet fetare.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 20 qershor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor në radio të SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, i transmetuar më 6 qershor 2023, në nivel shtetëror, në të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 54 paragrafi (5) të LSHMAAV, në mënyrë që pjesë të informacioneve të transmetuar në kuadër të edicionit të lajmeve, gjegjësisht në emisionet informative të shkurtra ditore me titull: "Lajmet në Radio Metropolis", janë sponsoruar nga ndërmarrja "Pneumatik" ( pneumatik .mk ), dhe në prezantimin dhe shpicën përmblylëse të edicionit " Një minutë lajm pozitiv ", u theksua se janë bërë (citim): "Së bashku me Drejtorinë për zonat e zhvilluara teknologjike- industriale dhe Këshilli i Investitorëve të Huaj ". Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer

programore ark. nr.10-2553/1 datë 20.06.2023, (tabela 1 dhe tabela 2 nga Raporti ), i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR RADIO METROPOLIS SHPK Shkup më 23.06.2023, dërgoi Shkresë ark.nr.10- 2553/2, datë 23.06.2023, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2553/1 datë 20.06.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë daklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi, për të cilin në afatin e paraparë SHTR RADIO METROPOLIS SHPK Shkup, ka dorëzuar deklarata me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV, me Nr.y në ark 10-2547/3 datë 27.06.2023. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 11.07.2023, shqyrtoi Raportin me shkrim në fjalë dhe deklarata të dorëzuar me shkrim dhe konstatoi se ndaj SHTR RADIO METROPOLIS SHPK Shkup t'i shqiptohet masë – vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 54 paragrafi (5) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022 dhe Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2553/1 datë 20.06.2023, për konstatim të mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV, paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 22-të, mbajtur në 11.07.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr. 02- 2749/4 datë 12.07.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR RADIO METROPOLIS SHPK Shkup dhe e urdhëron, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimi, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat nga LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2553/1 datë 20.06.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi mund të ngrijë padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.